

VLERËSIM I DISPOZITAVE LEGJISLATIVE DHE RREGULLATORE LIDHUR ME PUNËN E ENTIT SHTETËROR PËR REVIZION (ESHR)



VLERËSIM I DISPOZITAVE LEGJISLATIVE DHE RREGULLATORE LIDHUR ME PUNËN E ENTIT SHTETËROR PËR REVIZION (EShR)

Shkup, 2016

Projekti: Përmirësimi i llogaridhënies dhe transparencës financiare në Maqedoni

Zbatues: Fondacioni për demokraci i Vestminister (Maqedoni) në bashkëpunim me Qendrën për analiza ekonomike (QAE) dhe Instituti për studime komunikuese (ISK)

Përgatitur nga: Qendra për analiza ekonomike (QAE)

Botues:

Fondacioni për demokraci i Vestminister

Mbi botuesin:

Fondacioni për demokraci i Vestminister
rr. Naum Naumovski – Borçe 50/2-19
1000 Shkup
www.wfd.org

Autorë:

d-r Marjan Nikollov, ekspert i lartë
Gabriela Dimovska, ekonomiste në QAE

Qendra për analiza ekonomike - QAE

Bul. Jane Sandanski 63/3
1000 Shkup
Republika e Maqedonisë

info@cea.org.mk
www.cea.org.mk

Përkthyer nga gjuha angleze në gjuhën shqipe:

Kongresen servisen centar



British Embassy
Skopje

Ambasada Britanike Shkup mbështeti përgatitjen e këtij publikimi, brenda projektit "Përmirësimi i llogaridhënies dhe transparencës financiare në Maqedoni". Përmbajtja e këtij botimi nuk pasqyron domosdoshmërisht qëndrimin apo mendimet e Ambasadës Britanike.

PËRMBAJTJA

LISTA E SHKURTESAVE	6
1. HYRJE	7
2. KORNIZA LIGJORE	7
2.1. Mangësitë e kornizës ligjore	9
2.1.1. Nuk përcaktohet si kategori kushtetuese.....	9
2.1.2. Pavarësi dhe autonomi joadekuate	10
2.1.3. Pavarësia financiare	10
2.1.4. Korniza ligjore joadekuate për të rregulluar veprimet e auditorit shtetërorë gjatë dyshimit të arsyetueshëm për keqpërdorim ose krim.....	11
3. ASPEKTET PRAKTIKE DHE PROBLEMET	12
3.1. Veprimi në përputhje me zbulimet/raportet e ZSHR-së	12
3.2. Procedurat e brendshme dhe organizative të autoriteteve të autorizuara për të vepruar në bazë të raporteve/zbulimeve të ZSHR-së	16
4. TRANSPARENCA	18
5. PRAKTIKA NDËRKOMBËTARE	19
5.1. Rrjeti ndërkombëtar	19
5.2. Lloje të modeleve të revizionit të lartë.....	19
5.3. Përvojat ndërkombëtare.....	21
6. PROPOZIM REKOMANDIME PËR PËRMIRËSIMIN E PUNËS SË ZSHR-SË	24
RESURSET	25

LISTA E SHKURTESAVE:

BE	Bashkimi Evropian
OEILR	Organizata Evropiane e Institucioneve të Larta të Revizionit
ONILR	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve të Larta të Revizionit
LKBPF	Ligji për Kontrollin e Brendshëm dhe Publik Financiar
MF	Ministria e Financave
NCA	Gjykata e Revizionit e Holandës
PAC	Komisioni për Llogari Publike
RM	Republika e Maqedonisë
ILR	Institucionet e Larta të Revizionit
ZSHR	Zyra Shtetërore e Revizionit

1. HYRJE

Transformimi institucional i Zyrës Shtetërore e Revizionit (ZSHR) në Maqedoni ka filluar që prej vitit 1999, kur nëntë të punësuar nga Drejtoria për Revizion Ekonomik¹ dhe Financiar ishin transferuar në ZSHR që sapo themeluar. Që prej themelimit deri më ditën e sotme (Ligji për Revizion Shtetëror i parë i miratuar në vitin 1997²) ZSHR ka përjetuar zhvillimin në rrethana të proceseve intensive reformuese të sistemit për kontroll financiar dhe administratë publike dhe aktivitete intensive dhe procese për bashkëpunim me institucione shtetërore për qëllime të zbatimit të objektivave strategjike shtetërore për aderim në BE dhe integritime euro-atlantike.

ZSHR në përcaktimin e misionit synon sigurimin e informacioneve objektive dhe me kohë për autoritetet kompetente shtetërore dhe publikun për zbulimet nga revizionet e zhvilluara dhe me anë të rekomandimeve të qarta dhe efektive të drejtuar për përfituesit e fondeve publike për të kontribuar për përmirësimin e plotë të menaxhimit me financat publike.

2. KORNIZA LIGJORE

Zyra Shtetërore e Revizionit është institucion i lartë i revizionit në Maqedoni, që synon të informojë me kohë dhe në mënyrë objektive Asamblenë, Qeverinë dhe zyrtarët tjerë publik dhe opinionin e gjerë për zbulimet nga revizionet e zhvilluara. ZSHR-ja siguron mbështetje për Parlamentin për zbatimin e detyrave, me anë të identifikimit dhe prezantimit e parregullsisve dhe përdorimeve të paligjshme të entiteteve të reviduar, të zbuluara me revizionet e zhvilluara. Parimet kryesore të punës së ZSHR-së janë: pavarësia, objektiviteti, kompetenca, profesionalizimi, puna në ekip, transparencja dhe integriteti. ZSHR-ja është entitet ligjor dhe është i pavarur në zbatimin e revizioneve financiare, rregullsinë dhe revizione të përmbushjes. Kreu i ZSHR-së është Revizori i Përgjithshëm, që ka zëvendës. Revizori i Përgjithshëm dhe zëvendësi i tij zgjidhen nga Asambleja.

Korniza ligjore e revizionit shtetërore është rregulluar me Ligjin për Revizion Shtetëror, që është ndryshuar disa herë pas hyrjes në fuqi. Ligji i Revizionit Shtetëror i fundit ishte miratuar në maj të vitit 2010³. Ligji përcakton pozitën, rolin dhe misionin e ZSHR, pavarësinë dhe autonominë, si dhe autoritetet e organeve shtetërore dhe institucioneve, duke eliminuar përdorimin e paligjshëm dhe paqëllimshëm të fondeve publike, dhe mënyrat e ndjekjes së rekomandimeve të auditorëve të autorizuar shtetërore të prezantuar në raportet e lëshuara të revizionit. Ligji i Revizionit Shtetëror i fundit nga viti 2010 ishte ndryshuar 6 herë. Amendamenti i parë dhe tretë në përgjithësi ka të bëjnë me statusin ligjor të stafit të ZSHR dhe rrogat e tyre. Amendamenti i dytë dhe i pestë kanë të bëjnë me procedurat e zbatimit të provimit profesional për përfitimin e titullit të revizorit dhe kryesisht dispozitat për keqpërdorim. Amendamenti i katërt dhe gjashtë kanë të bëjnë me dispozitat e keqpërdorimit. Ligji i ri kërkon përputhje me Deklaratën në Lima për udhëzimet e perceptimeve të revizionit dhe Deklarata e Meksikës për pavarësinë e Institucioneve të Larta të Revizionit.


¹Nga viti 1991 deri në vitin 1998 revizioni i shtetit në RM ishte zbatuar nga Drejtoria për Revizion Ekonomik dhe Financiar (që ishte transferuar në Zyrë për Operime me Pagesa në vitin 1994).

²Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 65/97.

³Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 66/2010; 145/2010; 12/14; 43/14; 154/15; 192/15; 27/16.

Në përgjithësi, puna e procesit të planifikimit, përmbushjes dhe informimit për subjektet e revizionit është prezantuar në tabelën më poshtë:

Figura 1: Procesi i ZSHR për zhvillimin e revizioneve




Burimi: Ligji për Revizion Shtetëror

Duhet të përmendet këtu që kriteret dhe procedura për vendosjen se cilën kërkesë për zhvillimin e revizionit të pranohet janë për përdorim të brendshëm dhe nuk lejohet shpallja publike. Sipas ligjit, mandati i ZSHR për aktivitete tjera gjatë zhvillimit të revizioneve përfundon me dorëzimin e raportit të revizionit para entitetit të reviduar, Parlamentit dhe eventualisht autoriteteve (nëse ka zbulime të parregullive). Ligji nuk përcakton asnjë dispozitë ndëshkimore për entitetet që nuk do të marrin masa pas miratimit të raportit të revizionit në kuadër të periudhës përkatëse.

Procesi i komunikimit mes ZSHR dhe Parlamentit, ZSHR dhe Qeverisë ose Ministrisë së Financave, i përmbledhur dhe në përputhje me Ligjin paraqitet si më poshtë:

Figura 2: Komunikimi formal mes ZSHR dhe Parlamentit



Burim: Ligji për revizion shtetëror; Ueb faqja e EShR

Komunikimi mes ZSHR dhe Qeverisë është përcaktuar me Ligjin për Revizion Shtetëror dhe Rregullat e Qeverisë⁴.

⁴Rregullorja e Qeverisë së RM-së. Lexoni më tepër në: http://arhiva.vlada.mk/files/delovnik_zarabota.pdf

Figura 3: Komunikimi formal mes ZSHR dhe Qeverisë

Dorëzimi i raporteve të revizionit tek Qeveria	ZSHR dorëzon raportet e revizionit tek Qeveria për subjektet që janë nën pushtet qeveritar
Shqyrtim i raporteve nga Komisioni për revizion	Komisioni për Revizion është organ profesional qeveritar që sipas rregullave të Qeverisë, rishikon raportet e revizionit dhe dorëzon raporte me shkrim Qeverisë me mendime dhe propozim për masat e ndërmarra sipas rezultateve të raporteve të revizionit.
Sekretar i përgjithshëm informon ZSHR	Sekretari i përgjithshëm i Qeverisë njofton ZSHR mbi konkluzionet e marra nga Qeveria për masat e ndërmarra sipas rezultateve të raporteve të revizionit.
Dorëzim i raporteve relevante të revizionit tek Ministria e financave	ZSHR dorëzon çdo raport të revizionit tek MF ku ka konkluzione mbi punën financiare të subjektit të revizionit. Bashkëpunimi përcaktohet me Protokollin për bashkëpunim.

Burim: Rregullorja e Qeverisë;

Ueb faqja e EShR > Bashkëpunim me organet kompetente

Bashkëpunimi mes ZSHR dhe autoritetet: Komisioni Shtetëror për Parandalim të Korrupsionit, Prokurori Publik dhe Ministria e Punëve të Brendshme është aktivizuar dhe përcaktuar në Ligjin për Revizion Shtetëror (Neni 35). ZSHR-ja është obliguar që menjëherë të informojë autoritete kur ka ndonjë zbulim të keqpërdorimit ose krimi të bërë nga ndonjë prej entiteteve të reviduar. Në kuadër të bashkëpunimit me këto autoritete, ZSHR duhet rregullisht: (1) të dorëzojë raporte, informacione dhe materiale për zbulime që iniciojnë veprime nën kompetencën e Komisionit Shtetëror për Parandalim të Korrupsionit, Zyrës së Prokurorit Publik të Republikës së Maqedonisë dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme; (2) të sigurojë informacione dhe materiale për revizione të zbatuara në kërkesë të këtyre autoriteteve; dhe (3) të merr informacione kthyes nga këto autoritete për informacionet e parashtruara më herët, materiale dhe raporte të revizionit.

Sipas Ligjit, nuk ka më përshkrim të aktiviteteve që ZSHR-ja duhet të ndërmerr, ose nëse duhet të sigurohen informacione ose raporte për ZSHR-në si informacione kthyes, pas informimit të autoriteteve.

2.1. MANGËSITË E KORNIZËS LIGJORE

Më poshtë, do të komentojmë disa prej mangësive që kanë të bëjnë me misionin e ZSHR-së.

2.1.1. NUK PËRCAKTOHET SI KATEGORI KUSHTETUESE

Ndonëse ka përpjekje që Zyra Shtetërore e Revizionit të ketë pavarësinë dhe autonominë të inkuorporuar në Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe praktikën e mirë të shteteve të BE-së, dhe rekomandimet e Deklaratës së Limas për parimet udhëheqëse të revizionit, kjo çështje nuk është zgjedhur ende, ndonëse është një prej parakushteve të mëdha për aderim të mëtutjeshëm në BE.

Raporti i Progresit të BE-së nga viti 2010⁵, në Kapitullin 32 – Kontrolli Financiar dhe Lista e Prioriteteve Urgjente Reformuese⁶ rekomandon që ZSHR të përcaktohet nga Kushtetuta dhe të sigurojë nivel të mjaftueshëm të autonomisë së pavarësisë, jo vetëm në teori por edhe në praktikë, për të vepruar në mënyrë efektive dhe të lirë nga shtypja politike.

Sipas rekomandimeve të BE-së. Qeveria e RM-së ka dërguar Propozim për Amendamente Kushtetuese para Asamblesë Kombëtare më 27.07.2014. Amendamenti i tetë ka të bëjë me ZSHR pavarësia e saj kushtetuese. Që prej amendamenteve të propozuara, procesi i ndryshimit kushtetues nuk ka përfunduar ende për shkak të krizës politike dhe mungesa e kuorumit për të votuar ndryshimet kushtetuese⁷. Seanca e fundit të komisionit për temën ka qenë në korrik të vitit 2015⁸, kur ishte konfirmuar që procesi i ndryshimit nuk ka përfunduar. Pavarësia dhe autonomia e ZSHR-së janë rregulluar vetëm me ligj.

2.1.2. PAVARËSI DHE AUTONOMI JOADEKUATE

Ndonëse korniza ligjore e rregullon pavarësinë dhe autonominë e ZSHR-së, dhe jep pavarësi përkatëse operative si fuqinë e nevojshme për të zhvilluar revizione, duke marrë parasysh faktin që ZSHR duhet të respektojë rregullat e njëjta sikur çdo përdorues tjetër i buxhetit, në praktikë pavarësia dhe autonomia e institucionit janë të kufizuar nga aspekti ligjor dhe financiar. Kjo vonon procesin e zhvillimit dinamik të ZSHR-së dhe harmonizimin e operimit me praktikatat më të mira evropiane në kuptim të sigurisë së përmirësuar dhe përgjegjshmërisë së menaxhimit financiar me fondet publike.

2.1.3. PAVARËSIA FINANCIARE

Ligji i ndryshuar për ZSHR-në ka për qëllim të përforcojë pavarësinë operative dhe financiare të Zyrës Shtetërore të Revizionit dhe arritjes së efektivitetit dhe efikasitetit në zhvillimin e revizionit shtetëror. Nga figurat më poshtë mund të shohim që prej vitit 2011 pjesa e buxhetit qendror të ZSHR dhe rritjet e plota të buxhetit. Një pjesë e vogël e resurseve financiare për funksionimin e ZSHR sigurohen për të zbatuar dhe zhvilluar revizione komerciale.




Figura 1: Tendanca e fondeve financiare të ZSHR⁹
Burimi: Raportet vjetore të ZSHR, kalkulime personale

⁵Progres Raporti për 2010 i IRJ së Maqedonisë. Komisioni Evropian.

Lexoni më tepër në: http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2010/package/mk_rapport_2010_en.pdf. Qasur më 19.08.2016

⁶Prioritetet urgjente reformuese për IRJ të Maqedonisë. Komisioni Evropian. Lexoni më tepër në: Qasur më 19.08.2016

⁷Amendamente të reja ose pasiguri e re në Kushtetutë? Artikull në ueb portalin Pravdiko. Lexoni më tepër në:

Qasur më 22.08.2016

⁸Komisioni për Financa dhe Buxhet: Raporti i takimit të Komisionit nr. 54. 09.07.2015.

⁹Të dhënat për vitin 2016 janë projektuar nga Programi Vjetor i ZSHR-së.

TENDENCA E FONDEVE FINANCIARE TË ZSHR




Figura 2: Tendanca e fondeve financiare të ZSHR – vlera absolute
Burimi: Raportet vjetore të ZSHR, kalkulime personale

Raporti i fundit i PEFA 2015¹⁰ shënon që ZSHR nuk ka resurset e mjaftueshme për të zhvilluar revizione të plota financiare për gjithë entitetet çdo vit, dhe andaj synon të mbulon pjesën më të madhe në detal për një periudhë prej disa viteve.

Gjegjesisht: “Një raport i konsoliduar vjetor për gjitha aktivitetet e ZSHR-së gjatë vitit paraparak dërgohet Asamblesë Kombëtare çdo vit në qershor. Përveç kësaj, nga ZSHR-ja kërkohet që të zhvillojë revizion vjetor për zbatimin e Buxhetit Themelor të qeverisë qendrore, që nuk përfshin fondet për sigurim social, si dhe operacionet e financuar nga të ardhurave personale ose burime të jashtme. Revizioni i fundit është kufizuar në deklarata për të ardhura dhe shpenzime dhe nuk mbulon pronat dhe përgjegjësitë. Ajo përfshin disa testim të mostrave për të ardhura, por shpenzimet janë mbuluar vetëm në nivel të Arkës, pa mos bërë ndonjë testim të qëndrueshëm të transaksioneve në nivel të përdoruesve të buxhetit” – Vlerësimi i PEFA-së për IRJ të Maqedonisë.

2.1.4. KORNIZA LIGJORE JOADEKUATE PËR TË RREGULLUAR VEPRIMET E AUDITORIT SHTETËRORE GJATË DYSHIMIT TË ARSYETUESHËM PËR KEQPËRDORIM OSE KRIM

Korniza aktuale ligjore nuk përfshin autoritetin e ZSHR-së për të vepruar dhe imponuar sanksione në kuptimin ligjor ndonjë entiteti që ka dështuar të ndjek rekomandimet e revizorit të autorizuar shtetëror ose nuk ka siguruar informacione kthyesë për ZSHR në lidhje me statusin e rekomandimeve.

Korniza aktuale ligjore nuk përcakton qartë obligimin e organeve të autorizuar për të vepruar pas njoftimit të revizorit të autorizuar shtetëror për dyshimin e tyre të arsyetueshëm për keqpërdorim ose krim dhe për të informuar ZSHR në baza të rregullta për masat e ndërmarra deri sa të arrihet vendim përfundimtar nga Zyra e Prokurorisë Publike ose organeve të autorizuar ligjore në bazë të njoftimit paraparak nga ZSHR-ja.

¹⁰Vlerësimi PEFA për IRJ të Maqedonisë, nga John Wiggins, Jean-Marc Philip, Bojan Pogačar dhe Anto Bajo. Lexoni më tepër në: Qasur më: 22.08.2016

3. ASPEKTET PRAKTIKE DHE PROBLEMET

Në përputhje me kornizën ligjore të përcaktuar me ligj, Zyra Shtetërore e Revizionit lëshon dhe raporton para entitetit ligjor që është ekspozuar në revizion dhe organet e autorizuar¹¹ detyrat më poshtë:

- Raportet preliminare të revizionit, dhe
- Raportet finale të revizionit.

Entitetet e reviduar janë të obliguar me ligj të shqyrtojnë raportet e dorëzuar të revizionit dhe të veprojnë sipas rekomandimeve të revizorit shtetëror të autorizuar, dhe të sigurojnë informacione kthyesë për masat e ndërmarra për eliminimin e parregullsive jo më vonë se 90 ditë. Nuk janë përcaktuar obligime tjera të entiteteve të reviduar në Ligjin. Gjithashtu, Ligji nuk përcakton aktivitete tjera që ZSHR duhet të ndërmerr nëse entitetet e reviduar nuk i zbatojnë rekomandimet e ZSHR-së. Në përputhje me obligimet dhe afatet kohore të përcaktuar në Ligjin për Revizion Shtetëror, ZSHR-ja përpilon një raport vjetor dhe e dorëzon para Parlamentit të Republikës së Maqedonisë.

Qëllimet e dorëzimit të raportit vjetor në Parlamentin e Republikës së Maqedonisë janë këto më poshtë:

- Të informojë anëtarët e parlamentit, partitë relevante dhe opinionin për detyrat dhe obligimet e zbatuara nga Zyra Shtetërore e Revizionit.
- Të prezantojë parregullsi të identifikuar nga veprimi i revizorëve dhe mënyrën si ata përdorin fondet publike.
- Të prezantojë dobësitë ekzistuese sistemore dhe shkeljet e dokumenteve ligjore dhe rregullave tjera, dhe inkurajim të procesit të eliminimit të tyre.
- Ngritja e nivelit të angazhimit të organeve të autorizuar për të ndjekur rekomandimet e revizorëve të autorizuar shtetëror dhe eliminimin e situatave kundërshtuese.
- Të intensifikojë procesin e identifikimit të nivelit individual dhe personal të përgjegjësisë për mangësitë ekzistuese të veprimit të entitetit të reviduar, dhe për situatën e përcaktuar nga revizori i autorizuar shtetëror në lidhje me përdorimin e paligjshëm dhe paqëllimshëm të fondeve publike.
- Të intensifikojë procesin e nisjes së procedurave nga institucioni i autorizuar në rastet kur revizorët e autorizuar kanë njoftuar për dyshim të arsyetueshëm për keqpërdorim ose krim.
- Të ngrit vetëdijen për punë të përgjegjshme dhe efikase të personave që menaxhojnë fondet publike.
- Obligimi i entiteteve ligjore për transparencë dhe publicitet permanent të përdorimit të fondeve publike.

3.1. VEPRIMI NË PËRPUTHJE ME ZBULIMET/RAPORTET E ZSHR-SË

Dinamika e realizimit të spektrit të përcaktuar të punës së ZSHR për një vit përkatës është dhënë në Programin Vjetor të ZSHR-së. Të gjitha aktivitetet e zbatuara të ZSHR-së janë përshkruar në Raportin Vjetor.

¹¹Autoritete përkatëse të autorizuar janë: Parlamenti i RM, Qeveria e RM, Ministria e Financave, Zyra e Prokurorit Publik të RM, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, përdoruesit e fundit dhe ministrinë përkatëse dhe organe tjera që kanë funksione mbikëqyrëse sipas ligjeve sistemore që rregullojnë një fushë përkatëse.

Siç ishte përmendur më lartë, ZSHR zhvillon tre lloje të revizioneve: revizion financiar, revizion rregullator/përputhjeje dhe revizion përmbushjeje. Sipas Ligjit, **revizioni i fundit** kontrollon saktësinë dhe përmbushjen e regjistrave të llogarive dhe raporteve financiare. **Revizioni rregullator/përputhjes** është një proces i identifikimit dhe vlerësimit të përputhjes së gjitha entiteteve në përputhje me ligjin, aktet nënligjore dhe rregulloret e brendshme. **Revizioni i përmbushjes** vlerëson ekonominë, efikasitetin dhe efektivitetin e operacioneve dhe përdorimit të fondeve në një fushë të caktuar të aktiviteteve ose programeve.

Në vitin 2015, ZSHR-ja ka zbatuar 53 revizione, duke prodhuar 79 raporte të revizionit. Si përmbledhje, numri i revizioneve të zhvilluara dhe raporteve të prodhuara të revizionit sipas viteve janë dhënë në tabelën më poshtë.

Tabela 1. Numri i revizioneve të zhvilluara

Viti	# Revizione të zhvilluara					
	2015	2014	2013	2012	2011	2010
Revizion financiar dhe revizion të përputhjes	21	17	93	36	70	78
Revizion tematik/qëllime speciale	1	-	3	8	-	2
Revizion i përmbushjes LKBPF ¹²	13	80	-	-	-	-
Revizion i përmbushjes	18	6	7	10	7	7
Gjithsej revizione të zhvilluara	53	103	103	54	77	87

Burimi: Raportet Vjetore të ZSHR-së

Tabela 2. Numri i raporteve të prodhuara të revizionit

Viti	# Raporte të zhvilluara të revizionit					
	2015	2014	2013	2012	2011	2010
Revizion financiar dhe revizion të përputhjes	47	30	145	75	144	193
Revizion tematik/qëllime speciale	1	-	3	8	-	2
Revizion i përmbushjes LKBPF	13	80	-	-	-	-
Revizion i përmbushjes	18	6	7	10	7	7
Gjithsej raporte të zhvilluara të revizionit	79	116	155	93	151	202

Burimi: Raportet Vjetore të ZSHR-së

¹²Ligji për Kontrollin e Brendshëm dhe Publik Financiar. Lexoni më tepër në: http://finance.gov.mk/files/u249/JVFK_%D0%90%D0%BA%D0%B0%D0%B4%D0%B5%D0%BC%D0%B8%D0%BA%D0%B0_1.pdf

KRAHASIMI MES REVIZIONEVE TË ZHVILLUARA DHE RAPORTE TË REVIZIONIT TË ZHVILLUARA




Figura 3: Krahasimi mes revizioneve të zhvilluara dhe raporte të revizionit të zhvilluara
Burimi: Raportet vjetore të ZSHR, kalkulime personale

Në lidhje me entitetet ligjore që janë ekspozuar në revizion shtetëror dhe raportet e fundit të revizionit që përfshijnë zbulime të dobësive dhe përdorimit të paligjshëm dhe paqëllimshëm të fondeve, si dhe rekomandime për eliminimin e tyre, mund të arrihet në konkluzion që përpjekjet dhe angazhimi i entiteteve ligjore dhe autoritetet e autorizuara shtetërore kanë qenë joadekuate; ky konkluzion është arritur me anë të indikatorëve dhe fakteve më poshtë:

Tabela 3. Aktivitetet e ZSHR-së për vit:

Viti	Aktivitete të ZSHR-së					
	2010	2011	2012	2013	2014	2015
Revizione të zhvilluara	202	77	54	103	103	53
Tema e reviduar	169	148	128	170	168	410
# e zbulimeve	1067	1213	793	1146	1231	858
# i rekomandimeve	927	725	599	719	833	700
# aktiviteteve vijuese	122	118	84	57	70	11
# rekomandimeve të zbatuara	430	354	303	254	353	147

Burimi: Raportet Vjetore të ZSHR-së

Në përputhje me obligimin ligjor, Zyra Shtetërore të Revizionit ka dorëzuar raportet e fundit të revizionit në baza të rregullta para organeve të autorizuara gjatë viteve të fundit.

KUTIA 1.

Ndonëse ka aktivitete intensive dhe përpjekje nga Zyra Shtetërore e Revizionit, asnjë autoritet i autorizuar shtetëror nuk ka përkushtuar vëmendjen e nevojshme raporteve të revizionit që janë dorëzuar. Raportet nuk shqyrtohen dhe nuk merren përpjekje përkatëse për eliminimin e situatës aktuale, veçanërisht nga disa entitete ligjore. Nuk ka obligim ligjor për të nxitur veprim në bazë të raporteve të dorëzuar të revizionit para Asamblesë Kombëtare.

Ishte një befasi që pjesa më e madhe e deputeteve në Parlament nuk erdhën për të votuar mundësinë e detyrueshme ligjore të Parlamentit për të diskutuar për raportet e fundit të revizionit nga ZSHR-ja në vitin 2010 kur ishte miratuar ligji i ri për ZSHR. Duke vepruar si instrument i mbikëqyrjes ex-post i Parlamentit, ZSHR-ja dhe raportet e tyre kanë kuptim vetëm nëse diskutohen në komisionet parlamentare.

Rasti i vetëm kur Parlamenti dhe Qeveria e Republikës së Maqedonisë kushtojnë vëmendje revizionit është debati parlamentar për raportet vjetore të punës së ZSHR-së, dhe jo për raportet e entiteteve të reviduar.

Përveç kësaj, gjatë një seance të Qeverisë në vitin 2007, ishte miratuar një vendim që do të miratohet një propozim për Komision të Llogarive Publike të veçantë në parlament megjithatë ajo nuk ndodhi asnjëherë. Në seancën e njëjtë qeveritare ishte themeluar Komisioni për Revizion me mandat për të diskutuar raportet e ZSHR-së dhe të propozojë aktivitete për të zbatuar rekomandimet e ZSHR. Komisioni i Revizionit nuk ka pasur një seancë deri më tani.

Kjo situatë krijon një pengesë për ZSHR-në për të prezantuar në mënyrë eksplicite rezultatet në kuptim të efikasitetit, ekonomisë dhe efektivitetit. Për shembull, ZSHR-ja e MB-së ka prezantuar në vitin 2009 që ka kursyer 4.9 miliard funte britanike (që në atë kohë ishte ekuivalent i 140 spitaleve të reja) për 15 vite. Ose ZSHR-ja ka prezantuar që për çdo funte të shpenzuar në ZSHR kursehen 8 funte për taksapaguesit e Britanisë. Gjithashtu, ka prezantuar që mbi 90% të rekomandimeve të KLP-së ishin pranuar.

Tabela 4. Numri i raporteve të revizorëve të dorëzuar:

Viti:	Nr. i raporteve të revizionit të dorëzuar						
	2010	2011	2012	2013	2014	2015	Gjithsej
Parlamenti i RM-së	180	151	93	155	116	79	774
Prokuroria Publike	16	8	3	14	1	6	48
Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit	11	2	-	6	-	-	19

Burimi: Raportet Vjetore të ZSHR-së

Sipas raporteve vjetore të revizionit, Zyra Shtetërore e Revizionit identifikon shumë dobësi sistemore, konflikte mes dokumenteve ligjore dhe rregulloreve dhe dobësi organizative; megjithatë, ata vazhdojnë të përsëriten në disa raporte vjetore me rend. Kjo nënkupton mungesë të përpjekjeve nga autoritetet e autorizuara.

Duke themeluar Komisionin special me autoritet specifik të revizionit (autoritet qeveritar) ose përdorimi në Komisionin për Financa dhe Buxhet aktual, ZSHR ka theksuar nevojën e prezantimit të procedurave standarde për shqyrtimin e raporteve të revizioneve në Parlament. Me anë të komisioneve, ZSHR-ja është konfirmuar nga kontaktet e institucionalizuar mes Qeverisë dhe Parlamentit.

Në anën tjetër, Parlamenti i Republikës së Maqedonisë, me anë të mandatit, shqyrton Deklarata Vjetore Financiare të Buxhetit të RM-së për vitin paraprak; megjithatë, nuk shqyrton Raportin Final të ZSHR për të identifikuar situatën aktuale dhe të merren masat përkatëse për të eliminuar dobësitë.

ZSHR-ja dhe Sektori për Kontroll Publik Financiar i Brendshëm në Ministrinë e Financave ka nënshkruar Protokoll për Bashkëpunim në vitin 2006 dhe qëllimi është të përmirësojë sistemin e menaxhimit dhe kontrollit të fondeve publike. Megjithatë, Protokollin nuk është zbatuar ende në gjitha segmentet. Ministria e Financave në vitin 2012 ka themeluar Komisionin e Revizionit¹³, si autoritet konsultativ, që do të përforcojë bashkëpunimin me ZSHR dhe të ndjekin zbatimin e rekomandimeve të ZSHR-së për përdoruesit e buxhetit si entitete të revizionit. Megjithatë, sipas Tabelës 3 të prezantuar më herët, përpjesëtimet mes numrit të zbulimeve dhe rekomandimeve të zbatuara nuk ka ndryshuar shumë që prej themelimit.

Në përputhje me mandatin, ZSHR-ja dorëzon raporte të revizionit për Zyrën e Prokurorisë Publike për ndonjë dyshim për keqpërdorim ose krim. Bashkëpunimi i tyre është intensifikuar që prej vitit 2007, kur ZSHR dhe ZPP kanë nënshkruar Protokoll për bashkëpunim mbi parandalimin dhe shtypjen e korrupsionit dhe konfliktit të interesit¹⁴ (me 9 aktorë tjerë).

Sipas raportit të fundit vjetor, Zyra Shtetërore e Revizionit ka zbatuar aktivitete të ndryshme për eliminimin e situatave të veprimeve të dyshimta nga entitetet e reviduar (kontakte të reja, aktivitete të caktuara, tryeza të rumbullakët). ZSHR-ja ka vazhduar të përmirësojë punën me anë të zhvillimit dhe përdorimit të teknologjisë së informimit për përdorimin racional dhe efikas të revizionit. Në këtë drejtim, në vitin 2015 ZSHR-ja ka zbatuar në tërë aplikacionet: Kursi i revizioneve të rregullsisë dhe përmbushjes, që janë një udhëzim për procesin e revizionit.

3.2. PROCEDURAT E BRENDSHME DHE ORGANIZATIVE TË AUTORITETEVE TË AUTORIZUARA PËR TË VEPRUAR NË BAZË TË RAPORTEVE/ZBULIMEVE TË ZSHR-SË

Një prej arsyeve kryesore për angazhimin joadekuat të autoriteteve të autorizuara për të vepruar në bazë të zbulimeve/raporteve të ZSHR-së është struktura e brendshme e përcaktuar në mënyrë joadekuate. Në fakt, Rregulloret e parlamentit dhe Qeverisë së RM-së¹⁵ ose rregulloret tjera të brendshme të autoriteteve të autorizuara nuk përcaktojnë procedura dhe autoritete të organeve dhe trupave ose

¹³Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 90/2009. Lexoni më tepër në:

<http://www.slvesnik.com.mk/Issues/DB2C5103AB40DE4FBB7509FFF219D147.pdf> Qasur më 19.08.2016

¹⁴Protokollin për bashkëpunim për parandalimin dhe shtypjen e korrupsionit dhe konfliktit të interesit Lexoni më tepër në:

http://www.dksk.org.mk/index.php?option=com_content&task=view&id=188. Qasur më 28.08.2016

¹⁵Rregulloret e Parlamentit dhe Qeverisë së RM-së.

Lexoni më tepër në <http://www.sobranie.mk/delovnik-na-sobranieto-na-republika-makedonija-precisten-tekst.nsp> Qasur më 22.08.2016

metodën operative të zbatimit të roit të autoriteteve mbikëqyrëse dhe autoriteteve përgjegjëse dhe të autorizuar për të marrë masa dhe aktivitete për eliminimin e përdorimit të paligjshëm dhe paqëllimshëm të fondeve publike.

Një fakt mbete që autoriteti i çështjeve të revizionit shtetëror duhet të mbetet me Komisionin për Financa dhe Buxhet; megjithatë, kjo nuk është e përcaktuar qartë nga Rregulloret e Parlamentit. Me rëndësi është të përcaktohet autoriteti i komisioneve përkatëse të Parlamentit varësisht nga fusha e revidimit (p.sh. raporti i revizionit pas revizionit të Ministrisë së Kulturës duhet të shqyrtohet edhe nga Komisioni për Kulturë në Parlament).

Mbetet fakti që Qeveria e RM-së ka ndryshuar Rregulloret në shtator 2007 dhe ka themeluar Komisionin për Revizion si autoritet permanent ekspert për të shqyrtuar raportet e revizionit dhe për masat vijuese sipas raportit të revizionit/raporteve që ndërmerren nga entitetet e reviduar në bazë të rekomandimeve për eliminimin e parregullsive së përfshirë në raportet e revizionit. Komisioni i Revizionit dorëzon Qeverisë raportet me shkrim përfshirë edhe mendime dhe rekomandime për masat e ndërmarra në bazë të zbulimeve nga raportet e revizionit, në të cilat Qeveria do të bazojë dhe të merr konkluzionet përkatëse.

Nuk mjafton që Qeveria ka ndryshuar Rregulloret dhe ka themeluar Komisionin e Revizionit, pasi që nuk ka ndonjë shenjë që Komisioni ka shqyrtuar ndonjë raport revizioni të bërë mbi entitetit ligjore, madje as nuk ka dhënë informacione kthyesë në ZSHR për mënyrat e eliminimit të dobësive sistemore, veçanërisht pasi që këto dobësi janë autoritet ekskluziv dhe përgjegjësi e Qeverisë. Rregulloret e Qeverisë përcaktojnë që Sekretari i Përgjithshëm duhet të njoftojë ZSHR-në për konkluzionet e Qeverisë për masat e ndërmarra nga entitetet e revizionit në bazë të zbulimeve në raportet e revizionit¹⁶.

Tabela 5. Kategoria e statusit: Masa të ndërmarra në bazë të rekomandimeve të revizionit

Viti:	Masa të ndërmarra në bazë të rekomandimeve të revizionit					
	2015	2014	2013	2012	2011	2010
Rekomandime të zbatuara	147	561	254	303	354	440
Rekomandime jo të zbatuara	38	175	27	30	45	64
Rekomandime që nuk mund të zbatohen	0	2	9	7	7	0
Nuk ka informacione për rekomandimet	137	95	132	20	45	19

Burimi: Raportet Vjetore të ZSHR-së

Tabela më lartë tregon që për shkak të mungesës së obligimeve të përcaktuar qartë për zbatimin e rekomandimeve të ZSHR-së, vit për vit, numri i rekomandimeve të zbatuara nga entitetet e reviduar zvogëlohet, dhe në këtë kuptim, numri i rekomandimeve për të cilat nuk ka informacione kthyesë është zmadhuar.

Figura më poshtë tregon përpjekjet deklarative për rezultatet e ZSHR-së për të arritur me tepër efikasitet, ekonomik dhe efektivitet. Megjithatë nuk ka rezultate deri në këtë moment.

¹⁶Rregullorja e Qeverisë së RM-së. Lexoni më tepër në: http://arhiva.vlada.mk/files/delovnik_z_a_rabota.pdf Qasur më 22.08.2016




Tabela 1: Azhurnimet institucionale dhe ligjore të ZSHR

4. TRANSPARENCA

Funksionimi transparent i ZSHR-së është një prej pesë objektivave strategjike të përcaktuar në Strategjinë Zhvillimore të ZSHR¹⁷. Sipas Raportit Vjetor 2015, aktiviteti kryesor në procesin e transparencës ishte publikimi i raporteve finale të revizionit në ueb faqen si pjesë themelore e “Programit Vjetor të ZSHR në 2015”¹⁸.

Partneriteti Ndërkombëtar Buxhetor me anë të vegjlës për matje Anketa e Hapur Buxhetore¹⁹, përveç transparencës së Buxhetit Kombëtar, gjithashtu ndjek edhe të ZSHR-së në kuptim të transparencës. Në bazë të kriterëve të pranuar ndërkombëtare të zhvilluara nga organizatat multi-laterale, Anketa e Hapur Buxhetore përdor 5 indikatorë për të matur mbikëqyrjen buxhetore nga revizioni i lartë. Rezultatet nga anketa janë që mbikëqyrja buxhetore e ZSHR-së është adekuate. Me fjalë tjera, ZSHR-ja siguron mbikëqyrje përkatëse mbi buxhetin. Në bazë të Ligjit, ka të drejtë të plotë të bëjë revizion çdoherë që mendon se ka nevojë. Përveç kësaj, kreu i institucionit të lartë të revizionit nuk mund të largohet pa aprovim ligjor ose juridik, dhe me këtë duke përforsuar pavarësinë. Në fund, ZSHR-ja ka siguruar mjaft resurse për të plotësuar mandatin dhe të ketë një sistem adekuat të sigurimit të cilësisë.

Me kalimin e viteve, ZSHR-ja ka përmirësuar mbikëqyrjen mbi Buxhetin Kombëtar, në bazë të mënyrës më poshtë (ka mbledhur notën 100, prej 100 maksimale në vitin 2015):




Figura 4: Niveli i mbikëqyrjes buxhetore nga revizori (prej notës maksimale 100)
Burimi: Indeksi i Buxhetit të Hapur

¹⁷Strategjia zhvillimore e ZSHR-së. Lexoni më tepër në: http://www.dzr.mk/Uploads/Strategjia_razvoj_2013_2017_001.pdf

¹⁸Raport i Vjetor 2015 i ZSHR – së . Lexoni më tepër në: http://www.dzr.mk/Uploads/3_Godisen_izvestaj_DZR_2015_WEB.pdf

¹⁹Partneriteti Ndërkombëtar i Buxhetit – Anketa e Hapur Buxhetore.

Lexoni më tepër në: <http://www.internationalbudget.org/opening-budgets/open-budget-initiative/open-budget-survey/country-info/?country=mk>

5. PRAKTIKA NDËRKOMBËTARE

5.1. RRJETI NDËRKOMBËTAR

Për të pasur zhvillim të vazhdueshëm të punës së ZSHR-së, bashkëpunimi mes ZSHR dhe organizatat ndërkombëtare të institucioneve të larta të revizorëve është me rëndësi të madhe. Ky bashkëpunim synon²⁰:

- Shkëmbimi i njohurive, përvojave, metodologjive, materialeve, dokumenteve dhe informacioneve me ILR, grupe rajonale të punës (OEILR, etj.), organizata dhe shoqata profesionale;
- Harmonizimi i metodologjisë së revizionit në përputhje me standardet ndërkombëtare të pranuar të revizionit;
- Ndjekja e praktikave aktuale për zhvillimin e lëndës së revizionit;
- Sigurimi i informacioneve për aktivitete, rezultatet dhe efekte të punës së ZSHR-së në forumet ndërkombëtare; dhe
- Krijimi i reputacionit dhe imazhit të ZSHR-së në sytë e ILR tjerë dhe organizatat revizione në Evropë dhe gjithë botën.

ZSHR ka qenë anëtare e ONILR²¹ (Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve të Larta të Revizionit) që prej vitit 2001 dhe OEILR (Organizata Evropiane e Institucioneve të Larta të Revizionit) që prej vitit 2002. Përveç kësaj, Zyra Shtetërore e Revizionit është anëtare e grupit të punës së OEILR për Revizionin Mjedisor (që prej 2002) dhe TI (që prej vitit 2005)

Kompetencat e ZSHR-së dalin nga parimet kryesore të Deklaratave të Limas dhe Meksikos dhe Deklaratës së Tokios, që përcaktojnë rregullat themelore dhe udhëzimet për zhvillimin e revizionit, sigurimit të pavarësisë dhe përcaktimit të rolit të tyre për përgjegjshmëri të rritur.

5.2. LLOJE TË MODELEVE TË REVIZIONIT TË LARTË

ONILR funksionin në bazë të cilës mund të ketë vetëm një ILR për secilin vend. Nëse një vend ka më tepër se një organizatë që merret me revizionin publik të jashtë, atëherë është përgjegjësi e vendit të përcaktojë cila organizatë dëshiron që të regjistrohet në ILR, që zakonisht është autoriteti me garanci më të fuqishme kushtetuese të pavarësisë.


Ka tre modele të gjera të ILR. Ka një numër të ndryshimeve të këtyre tre modeleve dhe reformat e hershme në shumë vende janë duke shkuar drejt konvergencës së funksioneve, nëse jo në strukturë, të këtyre tre modeleve. Tre modelet kryesore janë këto më poshtë:

- **Modeli Westminster**, i njohur edhe modeli Anglo-Sakson ose Parlamentar që mund të vërehet në Mbretërinë e Bashkuar dhe shumë vende të Komonveltit, përfshirë edhe Afrikën Sahare, disa vende evropiane, si Irlanda dhe Danimarka dhe vendet e Amerikës Latine si Peru dhe Kili – që zakonisht quhen si zyra kombëtare të revizionit. Në sajë të modeleve Westminster, puna e ZSHR (ose Institucioni i Lartë i Revizionit – ILR) është lidhur ngjishtë me sistemin e përgjegjshmërisë parlamentare. Elementet kryesore janë: Autorizimi i shpenzimeve nga Parlamenti; prodhimi i llogarive vjetore nga gjitha departamentet e qeverisë dhe autoritetet tjera publike; revizioni i këtyre llogarive nga ILR; dorëzimi i raporteve të revizionit në Parlament për shqyrtim nga komisioni përkatës – zakonisht i quajtur Komisioni i Llogarive Publike (KLP); lëshim i raporteve dhe/ose rekomandimeve nga KLP; dhe përgjigja e Qeverisë për raportet e KLP-së. **ZSHR-ja e Maqedonisë është zhvilluar në bazë të modelit Westminster.**

²⁰Lexoni më tepër në ueb faqen e Zyrës Shtetërore të Revizionit. <http://dzt.mk/en/DesktopDefault.aspx?tabindex=0&tabid=1088>

²¹Kodi Etik, Zyra Shtetërore e Revizionit Lexoni më tepër në: http://www.dzt.mk/Uploads/ISSAI_30_%20Kodeks_etika_INTOSAI.pdf Qasur më 22.08.2016


Figura 4: modeli i përgjegjshmërisë Westminster



Burimi: Departamenti për Zhvillim Ndërkombëtar (DFID)²²

- **Modeli Juridik ose Napoleonik**, i vërejtur në vendet latine në Evropë, Turqi, vendet frankofone në Afrikë dhe Azi dhe disa vende të Amerikës Latine përfshirë Brazilin dhe Kolumbinë; shpesh të quajtur me emrin gjykata të revizionit ose gjykata të llogarive. Në Afrikën Frankofone, ky model mund të ekzistojë me inspektoratin e përgjithshëm shtetëror, që disa prej tyre mund të emërohen si ILR të vendit. Ata zakonisht janë pjesë e pushtetit ekzekutiv, por të pavarur nga ministritë dhe departamentet përkatëse. Një aspekt kryesor i modelit juridik është që zyrtarë relevant qeveritar janë zakonisht përgjegjës për shumën e përfshirë nëse vërehet pagesë e paautorizuar ose e paligjshme.

Figura 5: Modeli juridik



Burimi: Departamenti për Zhvillim Ndërkombëtar (DFID)²³

²²Departamenti për Zhvillim Ndërkombëtar. Lexoni më tepër në: <http://webarchive.nationalarchives.gov.uk/+http://www.dfid.gov.uk/aboutDFID/organisation/pfma/pfma-externalaudit-briefing.pdf>

²³Departamenti për Zhvillim Ndërkombëtar. Lexoni më tepër në: <http://webarchive.nationalarchives.gov.uk/+http://www.dfid.gov.uk/aboutDFID/organisation/pfma/pfma-externalaudit-briefing.pdf>

- **Modeli i Bordit ose Kolegjiumit**, i vërejtur në disa vende evropiane përfshirë Gjermaninë dhe Holandën, Argjentinën dhe vendet aziatike si Indonezi, Japoni dhe Republikën e Koresë. Struktura themelore e modelit është i ngjashëm me Westminster modelin, me dallime kryesore që gjenden në strukturën e brendshme të institucionit të revizionit. Me sistemin e kolegjiut, ILR përfiton një numër të anëtarëve që formojnë kolegjiut ose bordin e qeverisjes dhe merr vendime bashkërisht. Autoritetet e kolegjiut të revizionit zakonisht janë pjesë e sistemit parlamentar të përgjegjshmërisë. Raportet dhe mendimet e akorduara nga kolegjiuti dorëzohen Parlamentit, ku zakonisht ka ndonjë formë të Komisionit për Llogari Publike që veprojnë në bazë të raportit. Autoritetet e kolegjiut nuk kanë funksione juridike.

5.3. PËRVOJAT NDËRKOMBËTARE

GJYKATA E REVIZIONIT E SLOVENISË²⁴

Në përputhje me Kushtetutën e Sllovenisë, Gjykata e Revizionit e Republikës së Sllovenisë është autoriteti më i lartë për mbikëqyrjen e llogarive shtetërore, buxhetin shtetëror dhe gjitha shpenzimet publike në Slloveni. Gjykata e Revizionit është i pavarur nga përmbushja e detyrave dhe e lidhur me Kushtetutë dhe ligj.

Gjykata e Revizionit nuk mund të kategorizohet me asnjë prej tre degëve të pushtetit, ligjor, ekzekutiv ose juridik. Statusi i pavarur garantohet në disa drejtime nga Kushtetuta dhe me ligj:

- Gjykata e Revizionit ushtron fuqitë në mënyrë tërësisht të pavarur. Ajo është përgjegjëse për miratimin e programit personal për punë. Në përputhje me Ligjin për Gjykatën e Revizionit, deputetët dhe trupat e punës së Asamblesë Kombëtare, qeveria, ministritë dhe autoritet lokale mund të propozojnë që të zhvillohet ndonjë revizion; në mesin e këtyre propozimeve Gjykata e Revizionit zgjedh për programin vjetor të punës së paku pesë propozime nga Asambleja Kombëtare, dy prej të cilëve duhet të vijnë nga deputetët e opozitës dhe së paku dy nga trupat e punës së Asamblesë Kombëtare.
- Për mbulimin e kostove të aktiviteteve Gjykata e Revizionit propozon plan financiar para Asamblesë Kombëtare, që aprovon fondet e nevojshme të punës.

Natyrë publike e punës që zbatohet nga Gjykata e Revizionit është siguruar me lëshimin e raportit vjetor, që dorëzohet para Asamblesë Kombëtare. Raporti diskutohet në komisione në sajë të Asamblesë Kombëtare që zhvillohen në seanca të hapura për gazetarët dhe përfaqësues tjerë të medie. Përveç kësaj, raportet vjetore zakonisht jepen të gatshme në ueb faqen e Gjykatës ndërsa për raste të veçanta dhe çështje specifike organizohen konferenca për shtyp. Në raste të caktuara, deklaratat ose informacionet lëshohen në media, ndërsa mendimet e rëndësishme për çështjet e reviduar zakonisht jepen për publikim.

ZYRA SHETËRORE E REVIZIONIT TË KROACISË²⁵

Zyra Shtetërore e Revizionit është strukturuar si një institucion unik me Zyrë Qendrore në Zagreb dhe 20 zyra rajonale në qendrat e shtetit. Zyra qendrore në Zagreb dhe zyrat rajonale funksionojnë në gjithë territorin e Republikës së Kroacisë.

Aktivitetet, detyrat dhe përgjegjësitë e Zyrës Shtetërore të Revizionit janë përcaktuar nga Ligji për Zyrën

²⁴Faqja zyrtare e Gjykatës së Revizionit të R. së Sllovenisë. Lexoni më tepër në: <http://www.slovenia.si/slovenia/state/court-of-audit/>

²⁵Zyra Shtetërore e Revizionit në Kroaci, ueb faqja zyrtare. Lexoni më tepër në: <http://www.revizija.hr/en/>

Shtetërore të Revizionit dhe nga Karta e Zyrës Shtetërore të Revizionit. Zyra kryesohet nga Revizori i Përgjithshëm. Revizori i Përgjithshëm ka një zëvendës dhe ndihmës që i ndihmojnë në menaxhimin e Zyrës, dhe koordinojnë përmbushjen dhe aktivitetet e revizionit dhe tjerat në bashkëpunim me krerët e departamenteve dhe krerët e zyrave rajonale.

Zyra Shtetërore e Revizionit ka një Këshill Ekspertësh që është një autoritet këshillimor i Revizorit të Përgjithshëm dhe përbëhet nga Revizori i Përgjithshëm dhe deri më shtatë anëtarë të jashtëm – ekspertë të njohur, të përcaktuar nga Revizori i Përgjithshëm.

GJYKATA E REVIZIONIT E HOLANDËS²⁶

Gjykata e Revizionit e Holandës si “Këshill i Lartë i Shtetit” është autoriteti qendror qeveritar i krijuar për të siguruar që sistemi demokratik funksionon mirë. Këshillat e Lartë të Shtetit janë të pavarur nga qeveria.

Detyrat, fuqitë dhe statusi ligjor i Gjykatës së Revizionit janë dhënë në Kushtetutën dhe Ligjin për Llogari Qeveritare 2001. Behet fjalë për një institucion të pavarur. Ajo nënkupton që Gjykata vendos se çfarë do të revidojë. Gjykata shpesh merr kërkesa për të zbatuar revizione nga deputetë, ministra dhe sekretarë shtetërore që kanë nevojë për mendim të pavarur ekspert për ndonjë çështje të veçantë. Megjithatë nuk mund të urdhërojnë që të zbatohen kërkesën sepse Gjykata e Revizionit është e pavarur. Në praktikë, Gjykata zakonisht plotëson kërkesat e bërë nga deputetët ose qeveria, nëse mund të shtohet vlera. Gjykata përgjigjet me kujdes nga shenjave dhe reagimeve të shoqërisë, opinionit, ndërmarrjeve dhe organizatave. Gjykata mund të vendos, për shembull, t'i përfshijë në revizionin.

GJYKATA E LARTË E REVIZIONIT - REPUBLIKA ÇEKE²⁷

Ekzistimi i ZSHR-së është përfshirë në Kushtetutën e RÇ dhe për dallim me të tjerët, mandati i saj është nisur në një mënyrë tërësisht të re. ZSHR-ja kryen funksionet në mënyrë të pavarur, duke mos kërkuar mbështetjen e pushtetit ligjor (parlamentit) as pushtetit ekzekutiv (qeverisë).

Kushtetuta e Republikës Çeke, përveç pushtetit ligjor, ekzekutiv dhe juridik dhe elementet tjera kushtetuese, përcakton statusin e ZSHR-në si një autoritet të pavarur në një kapitull të veçantë, me dispozita që:

- Do të bëjë revizion të menaxhimit të pronës shtetërore,
- Kryetari dhe nënkryetari do të emërohen nga Presidenti i Republikës në propozim të Odës së Deputetëve për një mandat prej nëntë vite,
- Statusi, fuqitë dhe struktura organizative do të përcaktohen me ligj.

Për të siguruar shkallën më të lartë të objektivitetit gjatë shqyrtimit të çështjeve të reviduar dhe në vendim-marrje, parimi kolektiv është miratuar për punë në Zyrën. Për këtë arsye, vendimet për planifikimin dhe rezultatet e aktivitetet e revizionit të ZSHR-së merren nga autoritetet kolektive; varësisht nga rëndësia dhe natyra e revizioneve, ose nga gjithë Bordi me 17 anëtarë ose nga tre deri pesë anëtarë të Senatit. Bordi përbëhet nga Kryetari, nënkryetari dhe 15 anëtarë të Zyrës. Anëtarët e Zyrës zgjidhen nga Oda e Deputetëve të Parlamentit të Republikës Çeke; mandati i tyre zgjat në mënyrë të vazhdueshme deri sa të arrijnë moshën 65 vjeçe dhe statusi i tyre në nivel me statusin e anëtarëve të parlamentit.

Pavarësia institucionale e ZSHR-së plotësohet me pavarësinë plotësuese financiare. Institucionet e vetme që e përcaktojnë janë Oda e Deputetëve dhe buxheti shtetëror.

²⁶Faqja zyrtare e Gjykatës së Revizionit të Holandës. Lexoni më tepër në:

²⁷Zyra e Lartë e Revizionit të Republikës Çeke, ueb faqja zyrtare. Lexoni më tepër në: <http://www.nku.cz/en/default.htm>

GJYKATA E LLOGARIVE – RUMANI²⁸

Institucioni i lartë i revizionit në Rumani, Gjykata e Llogarive, është bazuar në dispozitat e Kushtetutës së Rumanisë. Ajo funksionon në mbështetje të Parlamentit dhe zhvillon aktivitetet në mënyrë të pavarur – në kuptimin funksional, operativ dhe financiar – nga entitetet që shqyrton.

Gjykata e Llogarive do të zhvillojë kontrollin e themelimit, menaxhimit dhe përdorimit të resurseve financiare të sektorit publik dhe shtetëror. Në përputhje me ligjin, çështjet gjyqësore që dalin nga aktivitetet e Gjykatës së Llogarive do të shqyrtohen në gjykata të specializuara.

Gjykata e Llogarive do të dorëzojë në Parlament, në baza vjetore, një raport për menaxhimin e llogarive të buxhetit kombëtar publik të veprimeve më të afërta buxhetore, duke identifikuar parregullsitë e gjetura.

Në kërkesë të Odës së Deputetëve ose të Senatit, Gjykata e Llogarive do të shqyrtojë menaxhimin e resurseve publike dhe do të raportojë për zbulimet.

Këshilltarët e Llogarive do të emërohen nga Parlamenti për një mandat prej nëntë vite, që nuk mund të zgjatet ose rinovohet. Anëtarët e Gjykatës së Llogarive do të jenë të pavarur në zbatimin e mandatit të tyre dhe nuk mund të zëvendësohen gjatë afatit përkatës. Ata do të jenë lëndë e mospërputhjeve të theksuara në ligjin për gjykatës.

Gjykata e Llogarive do të rinovohet me një të tretën e Këshilltarëve të Llogarive të emëruar nga Parlamenti, çdo tre vite, sipas kushteve të theksuar në ligjin për gjykatat. Anëtarët e Gjykatës së Llogarive mund të largohen nga ana e Parlamentit, në rastet dhe sipas kushteve të theksuara në ligj.

Tabela 6: Përmbledhje e institucioneve të prezantuara të revizionit^{29 30}

Vendi	Institucioni i revizionit	Rregullorja ligjore	Komunikimi/raportimi	Lloje të revizioneve të zbatuara
Slovenia	Gjykata e Revizionit	Kushtetuta dhe ligji	Gjykata e Revizionit dorëzon raporte vjetore para Parlamentit dhe Parlamenti aprovon fondet e nevojshme për punë	Ligjore, financiare, përbushje dhe përputhje dhe revizione për TI
Kroacia	Zyra Shtetërore e Revizionit	Ligji për Zyrë Shtetërore e Revizionit	Zyra Shtetërore e Revizionit dorëzon raportet vjetore dhe revizore Parlamentit në baza vjetore	
Holanda	Gjykata e Revizionit	Kushtetuta dhe Ligji për Llogari Qeveritare	Gjykata e Revizionit të Holandës në kuptim të Parlamentit punon për të siguruar kontrollin dhe shkëmbimin e informacioneve	Ligjore, financiare, përbushje dhe përputhje dhe revizione për TI
Republika Çeke	Zyra e Lartë e Revizionit	Kushtetuta	Presidenti i Zyrës dorëzon gjitha planet, kërkesat dhe raportet Bordit të Zyrës	Revizion financiar dhe revizion të përputhjes
Rumania:	Gjykata e Llogarive	Kushtetuta	Gjykata e Llogarive dorëzon raportet vjetore para parlamentit në baza vjetore	Revizioni i përputhjes, revizioni i përbushjes dhe financiare

²⁸Gjykata e Llogarive e R. së Rumanisë, ueb faqja zyrtare. Lexoni më tepër në: <http://www.curteadeconturi.ro/DefaultEN.aspx>

²⁹Për më tepër shikoni Dokumentin SIGMA nr. 33 [http://www.oecd.org/officialdocuments/publicdisplaydocumentpdf/?doclanguage=en&cote=ccnm/gov/sigma\(2002\)1](http://www.oecd.org/officialdocuments/publicdisplaydocumentpdf/?doclanguage=en&cote=ccnm/gov/sigma(2002)1) dhe Shqyrtim dhe krahasim i llogarive publike dhe praktikave të revizionit në 27 shtetet anëtare të BE-së <http://ec.europa.eu/eurostat/documents/1015035/4261806/study-on-public-accounting-and-auditing-2012.pdf/5ad43e2b-2ba7-4b05-afab-d690fc2ad9dd>

³⁰Të gjitha Rregulloret ligjore të Institucioneve të Larta të Revizionit mund të gjenden në: <http://www.eca.europa.eu/en/Pages/SupremeAuditInstitutions.aspx>

6. PROPOZIM REKOMANDIME PËR PËRMIRËSIMIN E PUNËS SË ZSHR-SË

REKOMANDIME PËR VENDIMMARRËSIT:

1. Miratim i ndryshimit të Kushtetutës në rastin e mundshëm, për të përfshirë revizionin shtetëror si kategori kushtetuese dhe përcaktimi i ZSHR-së si institucion i pavarur dhe autonom i lartë i revizionit në Republikën e Maqedonisë.
2. Miratimi i ndryshimit të Kushtetutës në rastin e mundshëm për të siguruar pavarësi të plotë financiare për revizionin shtetëror dhe të krijohet një buxhet i pavarur për Zyrën Shtetërore të Revizionit që do të aprovohet nga Parlamenti i RM-së në propozim të ZSHR-së dhe me mendim të Komisionit për Financa dhe Buxhet të parlamentit para aprovimit të Buxhetit të RM-së.
3. Ndryshimi i Ligjit për Revizion Shtetëror për të rregulluar statusin ligjor të revizorëve shtetëror dhe të përcaktojë përgjegjësitë e organeve të autorizuara në lidhje me rekomandimet e revizorëve të autorizuar shtetëror.
4. Përforcimi i të drejtave dhe autoriteteve të Zyrës Shtetërore të Revizionit në Ligjin për Revizion Shtetëror, për rastet kur një entitet ligjor ose autoritet dështon të ndjek/veprojë rekomandimet e revizorëve të autorizuar shtetëror.
5. Miratimi i ndryshimeve relevante të disa ligjeve sistemore dhe përcaktimi i kornizës ligjore dhe obligimin e Parlamentit të RM-së të shqyrtojë raportet vjetore të disa përdoruesve të fondeve publike bashkë me raportet e revizionit, si dhe obligimi për të reviduar Deklaratat Vjetore Financiare të Buxhetit të RM-së dhe zbulimeve nga revizioni, në përputhje me praktikën më të mirë të vendeve evropiane (në Holandë, revizioni shtetëror ka Ditën e Përgjegjshmërisë, kur Parlamenti shqyrton dhe diskuton raportet për revizionin e bërë të Buxhetit dhe përdoruesve të buxhetit);
6. Themelimi i komisionit për revizion ose nën-komision për revizion në sajë të Komisionit për Financa dhe Buxhet me rol të shqyrtojë raportet individuale të ZSHR-së.

REKOMANDIME PËR PUBLIKUN:

1. Ngritja e vetëdijes së organizatave qytetare dhe medieve për kontrollon e raporteve të publikuara të revizionit për institucionet e lidhura me punën e tyre.
2. Përmirësimi i kapaciteteve të organizatave qytetare dhe medieve për leximin e raporteve të revizionit dhe bërja e shtypjes me publikun nëse entiteti i reviduar nuk ndërmerr masa në bazë të rekomandimeve të revizionit.
3. Ngritja e vetëdijes së organizatave civile, medieve dhe publikut në përgjithësi për dërgimin e kërkesave për zbatimin e revizioneve.

RESURSET

1. Faqja zyrtare e Gjykatës së Revizionit të R. së Sllovenisë. Lexoni më tepër në: <http://www.slovenia.si/slovenia/state/court-of-audit/>
2. Departamenti për Zhvillim Ndërkombëtar. Lexoni më tepër në: <http://webarchive.nationalarchives.gov.uk/+http://www.dfid.gov.uk/aboutDFID/organisation/pfma/pfma-externalaudit-briefing.pdf>
3. Departamenti për Zhvillim Ndërkombëtar. Lexoni më tepër në: <http://webarchive.nationalarchives.gov.uk/+http://www.dfid.gov.uk/aboutDFID/organisation/pfma/pfma-externalaudit-briefing.pdf>
4. Strategjia zhvillimore e ZSHR-së. Lexoni më tepër në: http://www.dzr.mk/Uploads/Strategjia_razvoj_2013_2017_001.pdf
5. Strategjia zhvillimore e ZSHR-së. Lexoni më tepër në: http://www.dzr.mk/Uploads/Strategjia_razvoj_2013_2017_001.pdf
6. Kodi Etik, Zyra Shtetërore e Revizionit Lexoni më tepër në: http://www.dzr.mk/Uploads/ISILR_30_%20Kodeks_etika_ONILR.pdf
7. Kodi Etik, Zyra Shtetërore e Revizionit Lexoni më tepër në: http://www.dzr.mk/Uploads/ISILR_30_%20Kodeks_etika_ONILR.pdf
8. Partneriteti Ndërkombëtar i Buxhetit – Anketa e Hapur Buxhetore Lexoni më tepër në: <http://www.internationalbudget.org/opening-budgets/open-budget-initiative/open-budget-survey/country-info/?country=mk>
9. Partneriteti Ndërkombëtar i Buxhetit – Anketa e Hapur Buxhetore. Lexoni më tepër në: <http://www.internationalbudget.org/opening-budgets/open-budget-initiative/open-budget-survey/country-info/?country=mk>
10. Ligji për Kontrollin e Brendshëm dhe Publik Financiar. Lexoni më tepër në: http://finance.gov.mk/files/u249/JVFK_%D0%90%D0%BA%D0%B0%D0%B4%D0%B5%D0%BC%D0%B8%D0%BA%D0%B0_1.pdf
11. Rregulloret ligjore të Institucioneve të Larta të Revizionit mund të gjenden në: <http://www.eca.europa.eu/en/Pages/SupremeAuditInstitutions.aspx>
12. Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 90/2009. Lexoni më tepër në: <http://www.slv.esnik.com.mk/Issues/DB2C5103AB40DE4FBB7509FFF219D147.pdf>
13. Shqyrtim dhe krahasim i llogarive publike dhe praktikave të revizionit në 27 shtetet anëtare të BE-së <http://ec.europa.eu/eurostat/documents/1015035/4261806/study-on-public-accounting-and-auditing-2012.pdf/5ad43e2b-2ba7-4b05-afab-d690fc2ad9dd>
14. Vlerësimi PEFA për IRJ të Maqedonisë, nga John Wiggins, Jean-Marc Philip, Bojan Pogačar dhe Anto Bajo. Lexoni më tepër në: <https://pefa.org/sites/default/files/assessments/comments/MK-Dec15-PFMPPR-Public.pdf>
15. Protokollin për bashkëpunim për parandalimin dhe shtypjen e korrupsionit dhe konfliktit të interesit Lexoni më tepër në: http://www.dksk.org.mk/index.php?option=com_content&task=view&id=188

16. Rregulloret e Parlamentit dhe Qeverisë së RM-së. Lexoni më tepër në:
<http://www.sobranie.mk/delovnik-na-sobranieto-na-republika-makedonija-precisten-tekst.nspk>
17. Rregullorja e Qeverisë së RM-së. Lexoni më tepër në:
http://arhiva.vlada.mk/files/delovnik_za_rabota.pdf
18. Raporti Vjetor 2015 i ZSHR –së . Lexoni më tepër në:
http://www.dzr.mk/Uploads/3_Godisen_izvestaj_DZR_2015_WEB.pdf
19. Raporti Vjetor 2015 i ZSHR –së . Lexoni më tepër në:
http://www.dzr.mk/Uploads/3_Godisen_izvestaj_DZR_2015_WEB.pdf
20. Lexoni më tepër në ueb faqen e Zyrës Shtetërore të Revizionit:
<http://dzr.mk/en/DesktopDefault.aspx?tabindex=0&tabid=1088>
21. Dokumenti SIGMA nr.33
[http://www.oecd.org/officialdocuments/publicdisplaydocumentpdf/?doclanguage=en&cote=ccnm/gov/sigma\(2002\)1](http://www.oecd.org/officialdocuments/publicdisplaydocumentpdf/?doclanguage=en&cote=ccnm/gov/sigma(2002)1)
22. Ueb faqja e Zyrës Shtetërore e Revizionit
<http://dzr.mk/en/DesktopDefault.aspx?tabindex=0&tabid=1088>
23. Progres Raporti për 2010 i IRJ së Maqedonisë. Komisioni Evropian. Lexoni më tepër në:
http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2010/package/mk_rapport_2010_en.pdf
24. Prioritetet urgjente reformuese për IRJ të Maqedonisë. Komisioni Evropian. Lexoni më tepër në:
http://ec.europa.eu/enlargement/news_corner/news/news-files/20150619_urgent_reform_priorities.pdf

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

51.72.075.1:336.146(497.7)

NIKOLOV, Marjan

Vlërisim i dispozitave legislative dhe rregullatore lidhur me
punën e entit shtetëror për revizion (EShR) / [avtor Marjan
Nikollov, Gabriela Dimovska]. - Shkup : Fondacioni për demokraci i
Vestminister, 2017. - 28 стр. : граф. прикази ; 21 см

Публикацијата е во рамките на проектот: "Përmirësimi i
llogaridhënies dhe transparencës financiare në Maqedoni". -
Библиографија: стр. 25-26

ISBN 978-608-4773-36-8

1. Dimovska, Gabriela [автор]

а) Државен завод за ревизија (Скопје) - Анализа на работењето
COBISS.MK-ID 102689802

